

VENDIMNR. 02/1 DT. 06.06.2019I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË SHOQERISË "BANKA CREDINS " SH.A.

Sot, me datë 06.06.2019, në orën 12.00, në selinë e shoqërisë me adresë në Rr. "Vaso Pasha" Nr.8, Tiranë, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë BANKA CREDINS SH.A., shoqëri anonime shqiptare, regjistruar në mënyrë të rregullt në Regjistrin Tregtar, me Vendim Nr. 28969, të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë, datë 31.01.2003 (referuar më poshtë si "Shoqëria").

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme iu njoftua të gjithë aksionerëve, në mënyrë të rregullt në respekt të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të Shoqërisë, me datën 16.05.2019, me anë të postës së Bankës dhe po atë datë u publikua edhe në faqen e bankës në internet www.bankacredins.com. Njoftimi u shoqërua në mënyrë të rregullt nga dokumentacioni përkatës i mbledhjes.

Ishin të përfaqësuar në Mbledhje 75.81% e Kapitalit të Shoqërisë, e vërtetuar nga Lista e Pjesëmarrjes, e cila u nënshkrua nga të gjithë të pranishmit. Si konkluzion, Kuorumi i nenit 144 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me më shumë se 50% të kapitalit, është përmbushur. Mbledhja merr vendime me $\frac{3}{4}$ e aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Mbledhja e Asamblesë u drejtua nga z. Maltin Korkuti. Sekretar i Mbledhjes u caktua znj. Dora Vako.

Rendi i dites:

1. Propozim për rritjen e kapitalit të Bankës Credins në masën 4 milion Euro nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja.
2. Ngarkohet Drejtoria të bëjë njoftimet dhe regjistrimet përkatëse në përputhje me Ligjin.

Asambleja e Përgjithshme pasi konfirmoi kompetencën e saj për të vendosur duke u bazuar në Ligjin Nr 9662, datë 18.12.2006 " Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe në Statutin e shoqërisë, në formën e vendimit:



VENDOSI

1. Të zmadhohet kapitali i "BANKES CREDINS" SH.A. në vlerën 4,000,000.2 euro (katër milion euro) nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja. Në total numri i aksioneve që do të emetohen është 2,284,931 aksione me book value për aksion 1.7506 eur/aksion (book value për aksion është llogaritur mbi kapitalin e bankes sipas pasqyrave financiare IFRS date 31.03.2019 të pa certifikuar). Afati për të ushtruar të drejtën e parablerjes nga aksionerët e Bankes do të jetë jo më vonë se 20 dite pas publikimit të njoftimit për zmadhimin e kapitalit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, e drejtë kjo që do të materializohet me nënshkrimin e aksioneve të reja, në të kundërt aksionerët humbasin të drejtën e nënshkrimit. Në rast se aksionerët ekzistues heqin dorë nga e drejta e perparësise, ose e humbasin atë me kalimin e afatit 20 ditor, aksionet e panënshkruara mund t'i ofrohen personave të tretë Afati për shlyerjen e aksioneve të reja të nënshkruara, caktohet të jetë brenda dates 31.12.2019.
2. T'i delegojë Drejtorisë të gjitha kompetencat e nevojshme për të realizuar të gjitha procedurat në lidhje me kompletimin e transaksioneve të mësipërme, për të fiksuar modalitetet, për të gjetur investitore të mundshëm, për të nënshkruar kontratat e nënshkrimit, për të njoftuar Bankën e Shqipërisë lidhur me zmadhimin e kapitalit, si dhe për të bërë regjistrimet përkatëse pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve.

AKSIONARËT E SHOQËRISË

Aleksandër PILO

B.F.S.E Holding BV
përfaqësuar nga Xhet Hushi

Renis TËRSHANA

Unioni Shqiptar Kursim Kredie
përfaqësuar nga

Monika MILO

Fuad HAXHIYMERI

Emi SENTO

Neritan DOJAKA

Alba THOMOLLARI

Artur AGOLLI

Astrit HANA

Jorgjia BALLI

Akil ALIZOTI

Leonat KOCO



Veneranda BUSHATI

Edmond REXHO

Maltin KORKUTI



Elena HAXHIYMERI

Aida BUSHATI

Elisabeta HYSI


Bardhi HOXHA

Pandeli GARO


Egi SANTO



A.F.C sh.p.k
përfaqësuar nga **Shpend Sejdarasi**



Amryta Capital LLP
përfaqësuar nga **Xhet Hushi**



Albens BUSHATI

Violica BUSHATI

Tefik KOKONA

Mirela NDINI

Andon DAKA

EDRO sh.p.k
përfaqësuar nga

Arjan HANA

Edita HOXHA

Robert KASNECI

PRIMA SHPK
përfaqësuar nga

Helidon KOKONA



Hajrulla KALO

Lorenc BEJKO

Dritan TODHE

Fatmira DINA

Emond HOXHA



Mira MEKSI

Robert LUKAJ

Elvira BABOCI

Keti XHAMO



Shefki DOMA

Ashim DOMA

Petrit KASAPI



Suela HOXHA

Gjergj BUSHATI